



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 mars 2011
Nr. ref.: RK101 /11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 72/10

Parashtruesi

AGEF Gmbh përmes përfaqësuesve të autorizuar

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Kuvendit Komunal të
Prishtinës Nr. 353-1297, të datës 29 qershor 2010**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Organizata joqeveritare AGEF Gmbh, e regjistruar për veprim në Kosovë më 12 qershor 2000, nr. i regjistrimit 5300232-3, e cila kërkesën e ka parashtruar përmes përfaqësuesve të saj të autorizuar, avokates, znj. Iliriana Osmani Serreci dhe z. Virtyt Ibrahimaga nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është vendimi për anulimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Arkivit Komunal, Akademisë Gjermane (shkollës) për të Rritur (AGEF) 01. Nr. 353—1774, të datës 24. 09. 2002. Vendimet e sfiduara janë, vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës rev. 395/2008 i datës 02. 06. 2009 dhe Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Komunën e Pejës Ac. Nr. 306/06, i datës 25. 05. 2008.

Objekti i çështjes

3. Bazë e lëndës së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, më 30. 07. 2010, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 Nr. 353-1297, i datës 29.06.2010, me të cilin është anuluar Vendimi për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Arkivit Komunal, Akademisë Gjermane (shkollës) për të Rritur (AGEF) 01. Nr. 353—1774, të datës 24.09.2002, me kërkesë për shqiptimin e MASËS SË PËRKOHSHME të pezullimit të ekzekutimit të vendimit të KK – Prishtinë, **01 Nr. 353-1297, i datës 29. 06. 2010** nga Gjykata Kushtetuese.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me kushtetutë

4. Parashtruesi i kërkesës pohon se, me vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës është shkelur e drejta kushtetuese në mjetin efektiv juridik (neni 32 i Kushtetutës) dhe neni 22.3 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit 1 (1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (çdo personi fizik dhe juridik i garantohet shfrytëzimi i qetë i pronës së tij).

Baza juridike

5. Nenet 113 (7) dhe 116.2 të Kushtetutës; neni 48 dhe neni 49 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 16 dhjetor 2008, (nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejshëm: Ligji); neni 54 (b) dhe neni 69 i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese më 30. 7. 2010.
7. Më 2 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Zyrën e avokaturës I. O. T., e cila e përfaqëson parashtruesin e kërkesës, se Gjykata Kushtetuese e ka pranuar kërkesën e tyre dhe e ka regjistruar me nr. 72/10.
8. Me 2 gusht 2010, Gjykata Kushtetuese e njoftoi edhe Komunën e Prishtinës, si palë kundërshtare, lidhur me kërkesën e regjistruar dhe kërkoi nga komuna komentet eventuale lidhur me kërkesën.
9. Më 1 tetor 2010, Gjykata Kushtetuese i dërgoi një kërkesë për qasje në dosjen e lëndës C. nr. 1679/2010 Gjykatës Komunale në Prishtinë, pasi që kishte marrë njohuri se kjo lëndë kishte të njëjtin objekt shqyrtimi sikurse edhe lënda në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.
10. Më 10 gusht 2010 dhe më 15 shtator 2010, Komuna e Prishtinës ka dërguar komentet e veta lidhur me lëndën duke e mbrojtur vendimin e vet si të bazuar në ligj.
11. Më 14 dhjetor 2010, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Ivan Čukalović, Kolegji Shqyrtues i përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues) dhe Snezhana Botusharova e Altay Suroy, anëtarë të panelit, brenda të njëjtës ditë i paraqiti

rekomandimet e veta për të refuzuar lëndën si të papranueshme para përbërjes së plotë të Gjykatës.

Ankesa e parashtruesit

12. Parashtruesi i kërkesës ankohet se Kuvendi Komunal i Prishtinës me Vendimin 01 Nr. 353-1297, të datës 29. 06. 2010, në mënyrë jo kushtetuese dhe të paligjshme e ka anuluar vendimin e vet 01. Nr. 353-1774, të datës 24. 9. 2002 dhe kështu në mënyrë të njëanshme e ka ndërprerë Kontratën për shfrytëzimin e ndërtesës dhe të ngastrës, të përpiluar më 3. 10. 2002, sipas së cilës AGEF, si palë kontraktuese, ndërtesën e cila është lëndë e kontratës e shfrytëzon në afat prej 10 vjetësh, në pajtim me kushtet e theksuara në kontratë.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 24.9.2002, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka marrë Vendimin 01. Nr. 353-1774, për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Arkivit Komunal, Akademisë Gjermane (shkollës) për të Rritur (AGEF). Në pikën III (tre) të këtij vendimi është theksuar se kushtet e dhënies së objektit në shfrytëzim të përkohshëm do të caktohen me kontratë të veçantë, e cila do të lidhet ndërmjet Komunës dhe AGEF-it.
14. Më 3. 10. 2010, KK i Prishtinës, të cilin e përfaqëson kryetari i Kuvendit, z. Salih Gashi, në cilësinë e pronarit dhe Organizata Joqeveritare AGEF, të cilën e përfaqëson dr. Karin Lutze, në cilësinë e shfrytëzuesit, kanë lidhur kontratën për shfrytëzim të ndërtesës së Arkivit Komunal në Prishtinë, në rr. "Andrea Gropa", ngastra kadastrale 5941/5942, Komuna e Prishtinës.
15. Në nenin 3 (tre) të kontratës është parashikuar që pronari ia dorëzon shfrytëzuesit në shfrytëzim ndërtesën që është lëndë e kontratës në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vjetësh.
16. Në mbledhjen e mbajtur më 24. 6. 2010, Kuvendi Komunal i Prishtinës nxjerrë vendimin e regjistruar në protokoll, me numër 01, nr. 353-1297, për anulimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm të objektit të Arkivit Komunal, Akademisë Gjermane (shkollës) për të Rritur (AGEF) 01. Nr. 353—1774, të datës 24. 09. 2002, me vërejtje në pikën VI (gjashtë) të Vendimit që ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Kuvendin Komunal, kurse konform pikës III të këtij vendimi, AGEF duhet ta lirojë ndërtesën, të cilën e ka shfrytëzuar, nga njerëzit dhe sendet në afatin prej 30 ditësh nga nxjerrja e këtij Vendimi.
17. Më 07. 07. 2010, KK i Prishtinës, përmes Drejtorisë së Financave dhe Pronës, zyrtarisht e ka njoftuar AGEF-in për vendimin e vet.
18. Më 22 korrik 2010, AGEF Gmbh, përmes përfaqësuesit të vet të autorizuar, avokatit Avdi Ahmetaj, nga Prishtina, i ka paraqitur KËRKESË Gjykatës Komunale në Prishtinë për caktimin e MASËS SË PËRKOHSHME për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të KK të Prishtinës 01. Nr. 353-1297, të datës 29. 06. 2010.
19. Gjykata Komunale në Prishtinë, duke vendosur sipas kërkesës së AGEF-it, të datës 4. 8. 2010, ka nxjerrë Aktvendimin C. nr. 1679/10, me të cilin ÇAKTON masën e përkohshme të sigurisë dhe ia ndalon KK të Prishtinës ekzekutimin e Vendimit 01 nr. 353-1297, të datës 29. 6. 2010, duke e obliguar në të njëjtën kohë propozuesin (AGEF) që në afatin prej 30 ditësh, nga dita e miratimit të masës së përkohshme të sigurisë, të ngrit padi kundër kundërshtarëve të masës së sigurisë për çështjen e cila është lëndë e kërkesës për përcaktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

20. Më 1 tetor 2010, Gjykata Kushtetuese drejtpërsëdrejti i ka dorëzuar Gjykatës Komunale në Prishtinë kërkesën nr. ref. 1442/10 DRLSA, për qasje në shkresa të lëndës C. 1679/10, e që është në lidhje me lëndën e cila shqyrtohet në Gjykatën Kushtetuese, dhe menjëherë nga Gjykata Komunale ka marrë kopjen e padisë C. nr. 1679, nga e cila shihet qartë që AGEF-i, përmes përfaqësuesit të vet, avokatit z. Selim Nikçi, në cilësinë e paditësit, e ka paditur Komunën e Prishtinës për konfirmimin e ekzistimit të kontratës, vlera e kontestit 3.500.00 €.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës për masën e përkohshme dhe meritumin

Masa e përkohshme

21. Për të qenë në gjendje për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit të saj, Gjykata paraprakisht duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë që janë caktuara në Kushtetutë.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata thirret në nenin 116.2 të Kushtetutës, i cili parashikon:

Përderisa procedura të mos përfundojë para Gjykatës Kushtetuese, Gjykata mund të pezullojë përkohësisht aplikimin e aktit apo të ligjit të kontestuar, derisa të merret vendimi i Gjykatës, nëse konsideron që aplikimi i aktit ose i ligjit tillë të kontestuar, mund të shkaktojë dëm të pariparueshëm.

Edhe neni 27. i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikon:

Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të palës mund të marrë vendim për aplikimin e masave të përkohshme në raport me ndonjë çështje që është lëndë e procedurës, nëse ato masa janë të domosdoshme për evitimin e rreziqeve apo të dëmit të pariparueshëm, apo nëse ndërmarrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

Gjykata, po ashtu, e ka parasysh nenin 51 pika 2 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese, që thotë:

Kërkesa do t'i përmbajë arsyet specifike të kërimit të masave të përkohshme, pasojat e mundshme nëse nuk aplikohen edhe masat konkrete të cilat kërkohen.

23. Nga normat e sipër theksuara del se kusht esencial për përcaktimin e masave të përkohshme është dëmi i pariparueshëm (pakompensueshëm) që do të mund të shkaktohej për parashtruesin e kërkesës dhe mbrojtja e interesit publik. Është po ashtu, detyrim i parashtruesit të kërkesës që në mënyrë shumë të argumentuar ta arsyetojë kërkesën për përcaktimin e masave të përkohshme.

24. Duke pasur parasysh pretendimet në kërkesën e AGEF-it, Gjykata është e qëndrimit që parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi të cilat përcaktimin e masave të përkohshme do ta bënin të domosdoshëm. Parashtruesi i kërkesës nuk ka theksuar se çfarë dëmi specifik i pariparueshëm do të shkaktohej për të nëse masa e përkohshme nuk do të përcaktohej dhe për ç'arsye ai dëm nuk do të mund të evitohet, madje edhe me vendimin përfundimtar të Gjykatës. Parashtruesi i kërkesës, po ashtu, nuk ka theksuar se si me vendimin e KK të Prishtinës është shkatërruar interesi publik dhe në ç'mënyrë ky interes, me masën eventuale të përkohshme të Gjykatës, do të mbrohej.

25. Madje, edhe po qe se parashtruesi i kërkesës e ka argumentuar në masë të mjaftueshme ekzistimin e rrezikut të bazuar për dëm të pariparueshëm, të shkaktuar nga aplikimi i vendimit të KK të Prishtinës, ky rrezik është evituar përmes përcaktimit TË MASAVE TË

PËRKOSSHME TË SIGURISË të Gjykatës Komunale në Prishtinë me aktvendimin C. nr. 1679, të datës 04. 08. 2010, dhe kjo masë është edhe më tutje në fuqi, ashtu që Gjykata Kushtetuese nuk do të mund të përcaktojë Masën e përkohshme në lëndën sipas së cilës tashmë është përcaktuar Masa e përkohshme.

26. Nga arsyet e sipër theksuara, Gjykata unanimisht vendos që kërkesën për Masa të përkohshme ta refuzojë.

Vlerësimi i aspekteve esenciale të kërkesës

27. Përmes shqyrtimit të gjitha argumenteve të parashtruara nga palët në lëndë, nxirret përfundimi që kërkesa e ushtruar në Gjykatën Kushtetuese nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të AGEF-it, është e parakohshme dhe se nuk është paraqitur në pajtim me nenet 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse:

28. Në kërkesën e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të KK të Prishtinës, përfaqësuesit e autorizuar të Organizatës Joqeveritare AGEF GmbH, kanë pohuar se Vendimi i Kuvendit Komunal të Prishtinës 01 Nr. 353-1297, i datës 29. 06. 2010, është akt politik, se nuk e ka cilësinë e aktit administrativ dhe si i tillë nuk ofron mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve juridike për kontestimin e tij para organeve kompetente, ndonëse kjo e drejtë është kategori kushtetuese juridike, e parashikuar me nenin 32 të Kushtetutës.

29. Nëse Gjykata do t'i pranonte pohimet e parashtruesit të kërkesës dhe do të kishte qëndrim që Vendimi i KK të Prishtinës nuk e ka cilësinë e aktit administrativ, por se është vendim politik, në atë rast Gjykata do të duhej ta shpallte politik edhe Vendimin 01. Nr. 352-1774, të datës 24. 09. 2002, me të cilin ndërtesa që është lëndë e kontestit, i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm AGEF-it dhe i cili ka parashikuar detyrimin e arritjes së KONTRATËS për shfrytëzimin e ndërtesës, dhe që i përcakton të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

30. Me Ligjin e Procedurës Administrative (Nr. 02/L-28), neni 1, paragrafi 4, është parashikuar:

Dispozitat e këtij ligji nuk vlejné për format vijuese të veprimtarisë së organeve të administratës publike:

a) aktet administrative të karakterit regulativ;

b) aktet administrative të cilat kanë të bëjnë me organizimin e brendshëm të organeve të Administratës publike; dhe

c) aktet administrative të cilat i lëshojné organet e Administratës publike në kuadër të transaksioneve private në të cilat Administrata publike është njëra palë.

Duke pasur parasysh nga sa u tha më lart, del se vendimi i kontestuar i KK të Prishtinës nuk bën pjesë në asnjërën nga kategoritë e theksuara, prandaj ai është nxjerrë në procedurën administrative dhe se mund të kundërshtohet përmes procedurës administrative.

31. Madje edhe me supozimin se kontesti administrativ nuk ka mundur të iniciohej, Gjykata konsideron që neni 82, paragrafi 1, i Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale (Ligji 03/L-040) parashikon mundësinë e kontestimit të vendimeve të kuvendeve komunale në kuadër të Ministrisëkompetente të vetëqeverisjes lokale.

32. Organizata Joqeveritare AGEF, përmes avokatit z. Selim Nikçi, ka ushtruar padi në Gjykatën Komunale në Prishtinë për Konfirmimin e ekzistimit të Kontratës që e ka lidhur më herët me KK të Prishtinës dhe e cila është pasojë e vendimit të KK të Prishtinës 01 Nr. 353-1774, të datës 24. 09. 2002, dhe kjo procedurë është në vazhdim e sipër.

33. Duke iu referuar nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetute, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Bazuar si në më sipër, Gjykata konstaton se nuk mund të shqyrtojë një kërkesë para se të shteren të gjitha mjetet juridike në dispozicion, që në rastin konkret shihet qartë se nuk ka ndodhë.

34. Për më tepër, Gjykata dëshiron të theksoj se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'u ofrojë autoriteteve në fjalë, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës, do të sigurojë mjet efikas ligjor kundër shkeljes të së drejtave kushtetuese (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni v. France nr. 25803/94, vendim i 28 korrikut 1999).

35. Gjykata gjithashtu, përcakton se thjeshtë një dyshim, për sa i përket perspektivës së çështjes, nuk është i mjaftueshëm për të përjashtuar një ankues nga detyrimi i tij për t'u ankuar në organet kompetente vendase (shih Whiteside v the United Kingdom, vendimi i datës 7 mars 1994, kërkesa nr. 20357/92, DR 76, f.80).

36. Në këto rrethana parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kushtet për pranueshmërinë e kërkesës, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese më 14 dhjetor 2010 njëzëri:

VENDOS


I. TA HEDHE POSHTË kërkesën si të papranueshme;

Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtari Raportues

Ivan Čukalović



6

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

